



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e **Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF)**, e mbajtur më **15.07.2025**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! I nderuar nënkryetar i komunës, **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të OSBE-së, të gjithë ju të pranishëm. E hapim mbledhjen **e shtatë (7)** të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2025. Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë rend dite;

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Raportit 6 - mujor i punës së Zyrës së Prokurimit për vitin 2025;
3. Shqyrtimi i Raportit të DKA-së rreth përfundimit të vitit mësimor, 2024/2025;
4. Shqyrtimi i Raportit Financiar, janar - qershor 2025;
5. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, janar – qershor 2025;
6. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2024;
7. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, janar – qershor 2025;
8. Të ndryshme.

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të KPF-së, rendin e ditës e vendosim në votim rendin e ditës. Kush është “për”?... Konstatohet që unanimisht aprovohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A kemi diçka në lidhje me procesverbalin nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Unanimisht aprovohet pika e parë.

2. Shqyrtimi i Raportit 6 - mujor i punës së Zyrës së Prokurimit për vitin 2025:

Kryesuesi: Zyrtari i prokurimit nuk është i pranishëm, i ka pasur disa arsye.

Burim Krasniqi: Faleminiderit kryesues! Zyra e prokurimit ka më shumë se veç shefin e prokurimit dhe ka mundur të jetë i pranishëm dikush tjetër. Konsideroj që këtë pikë është mirë ta shtyejmë për seancën e radhës.

Kryesuesi: Kjo pikë kështu-ashtu nuk votohet dhe në seancën e rregullt ai do të jetë i pranishëm.

Burim Krasniqi: Konsideroj që, KPF-ja e meriton të degradohet në këtë situatë! Shumë pika nuk vijnë, sepse nuk ka nevojë të jenë në KPF. Plot çështje vijnë veç në seancë. Është fakt që sipas legjislacionit në fuqi, informatat dhe raportet nuk votohen, por nëse duhet të diskutohen në seancën duhet të kalojnë nëpër filtrin e KPF-së.

Defrim Kafexhiu: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar nënkryetar, anëtarë të KPF-së, të nderuar dy drejtorë të drejtorive. Pajtohem me Burimin që, pavarësisht që ju e shihni si formalitet pjesën e mbledhjeve të KPF-së, nuk

duhet të anashkalohej në këtë formë. Përveç kësaj, mungojnë shumë drejtorë që i kanë pikat e rendit të ditës dhe kjo është gabim. Shumë pak prej drejtorave kanë qenë korrekt në KPF, përgjatë mandatit me prezencën e tyre.

Nënkryetari: Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, të nderuar dy drejtorë të pranishëm dhe i përshëndesim edhe ata që janë në punë. Raportet dhe informatat dërgohen në KPF dhe ju besoj që e keni këtë raport. Ju ftoj që t'i diskutoni këtu, por edhe në seancën e rregullt të kuvendit. Sa i përket prezencës së drejtorëve në KPF, ju mund ta shihni se sa seriozë jeni ju me pjesëmarrje. Përndryshe, në asnjë pikë nuk kanë munguar drejtorët që i kanë pasur pikat për KPF, veç kur kanë pasur agjendë tjetër dhe e kanë autorizuar dikë tjetër.

Kryesuesi: Faleminderit nënkryetar! Po e jap edhe unë një koment: nuk ka asnjë lloj formaliteti e as tendence, të gjitha pikat çdo herë janë prezentuar dhe për diskutime shitesë ka qenë nënkryetari.

3. Shqyrtimi i Raportit të DKA-së rreth përfundimit të vitit mësimor, 2024/2025:

Nënkryetari: Ju informoj që drejtori i Drejtorisë për Arsim është liruar nga detyra dhe u.d i drejtorit të DKA-së është Afrim Limani. Po e prezentoj shkurtimisht këtë raport të arsimit: Raporti është i ndarë në 4 periudha dhe janë të parapara të gjitha aktivitetet. Nëse keni nevojë edhe do t'ju lexoj.

Burim Krasniqi: Të njëjtin shqetësim e ka thënë edhe më herët! Raporti më shumë mban aktivitete të punës të drejtorit dhe të DKA-së, se sa për vitin shkollor. Puna e DKA-së dhe viti shkollor 2024-2025 janë dy gjëra të ndara. Ju kërkoj që në seancën të kemi informata mbi stafin, mbi numrin e mësimitdhënësve, mbi numrin e nxënësve, numrin e maturantëve, nota mesatare etj... Raporti të ketë më shumë informata statistikore të arsimit për seancën e kuvendit. Është sfiduese që mbi 30% të semimaturanëve e vazhdojnë shkollën jashtë komunës së Rahovecit, pra, në Gjakovë dhe Prizren. Mund të jemi rivalë politikë dhe të kemi mendime të ndryshme politike, por sa i përket çështjeve jetike për komunë, nuk besoj që mund të luftojmë se kush po doket më mirë. Kjo çështje është sfidë për shkollën e Krushës dhe të Ratkocit, sepse numri i nxënësve në këto dy shkolla vazhdon me rënie drastike. Duhet të diskutojmë për një zgjidhje më të mirë.

Defrim Kafexhiu: Do të dëshiroja që në raport të DKA-së t'i tregoni edhe sfidat gjyqësore të kësaj drejtorie dhe proceset gjyqësore që kanë përfunduar. Një pyetje: drejtori i liruar, ka dhënë dorëheqje apo është shkarkuar?

Nënkryetari: Plotësisht pajtohem me Burimin për plotësimin e kësaj informate. Nuk e di sa ka kohë, sepse materiali për kuvend shpërndahet sot, eventualisht nesër. Sido që të jetë, kërkoj nga drejtori që ta plotësojë raportin me statistikat e kërkuara. Sa i përket shkollës së mesme, sa e di unë ligjërisht është shkollim vullnetar dhe secili orientohet ku të don. Ndoshta hartimi i politikave të mirëfillta që qëllim e kanë mbajtjen e nxënësve në shkollat vendore duhet të bëhet me Ministrinë e Arsimit. Sa i përket aspektit të shkarkimit ose lirimit të drejtorit, ju tregoj në seancën e kuvendit komunal, sepse aty do ta sulmoni, jo për gjë tjetër, por për shkak të zgjedhjeve. U.D. për Drejtorinë e Arsimit është Afrim Limani, që njëkohësisht është edhe drejtor i Drejtorisë së Financave.

4. Shqyrtimi i Raportit Financiar, janar - qershor 2025:

Afrim Limani: I nderuar kryesues, nënkryetar, të nderuar ju anëtarë të KPF-së. Tani unë jam u.d të drejtorit të Arsimit dhe me kërkesë të Burimit, për mbledhjen e kuvendit ia shtojmë edhe elementet statistikore të kërkuara. Raporti 6-mujor financiar është voluminoz dhe është i përbërë me të gjitha të dhënat e nevojshme që kanë ndodhur brenda këtij 6 muajshi. Është pjesa e të hyrave, pjesa e shpenzimeve, obligimet financiare, obligimet kontraktuale, si dhe kontratat e lidhura deri më tani. Të hyrat për 6 muaj janë 1.124.000€, kur e krahasojmë me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar kemi një diferencë pozitive prej 231.000€. Gjohet e gjykatave të trafikut, për këtë tre muaj të dytë ende nuk kanë ardhur. Raporti përbëhet edhe nga pjesa e inkasimit të të hyrave sipas kodeve ekonomike. Në raport gjithashtu janë edhe të dhënat e tatimit në pronë. Dallimi i tatimit në pronë me 6 mujorin e vitit të kaluar është plus 25.947€. Shpenzimi i buxhetit në total është 14.453.000 (68.88%). Obligimet kontraktuale në total janë 13.972.000€ dhe nga kjo vlerë 9.950.000 janë investime kapitale, 3.645.000 janë mallra dhe shërbime dhe 376.000 janë subvencione. Për fund, kemi likuiditet të mjaftueshëm financiar për mbulimin e obligimeve kontraktuale.

5. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, janar – qershor 2025:

Nënkryetari: Informatën e keni para vetes dhe ajo që është më e rëndësishme, është që ka përfunduar aplikimi për subvencione që lidhet me Ministrinë e Bujqësisë. Dallimi i aplikuesëve në krahasim me vitin 2024 është 46 fermerë më pak, por sipërfaqja afërsisht llogaritet që është e njëjtë. Gjithashtu, është nënshkruar një memorandum me Qatar Charity, organizatë që financon kryesisht serra me nga një ari për shtresat sociale. Të detajuara janë të gjitha projektet që zhvillohen në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë.

6. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2024:

Afrim Limani: Auditimi i pasqyrave financiare i Komunës së Rahovecit për vitin 2024 ka rezultuar me opinion të pamodifikuar, kjo i bie që raporti është pozitiv. Ky raport ka prodhuar 6 rekomandime, prej tyre 4 rekomandime janë të reja dhe 2 janë të përsëritura. Historikisht Komuna e Rahovecit nuk ka pasur më pak rekomandime. Jemi një ndër të paktat komuna që kemi dalur me opinion të pamodifikuar dhe në nivel vendi janë vetëm tri komuna që kanë dalur mirë. Kjo gjendje është e mirë dhe na hap rrugë në thithjen e fondeve.

6. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, janar – qershor 2025:

Nënkryetari: Informatën e keni në email me të gjitha aktivitetet që janë zhvilluar. Këtë informatë e kemi për ta respektuar kalendarin e punës së kuvendit. Gjatë periudhës janar-qershor gjithsej janë kryer 58.217 shërbime. Duke mos dashur ta zgjas më tepër, këtë informatë do ta diskutojmë më shumë në seancën e kuvendit komunal.

7. Të ndryshme:

Defrim Kafexhiu: Për nënkryetarin e kam një pyetje dhe një kërkesë për drejtorin e Gjeodezisë dhe Kadastrës. Në seancën e rregullt të na informojë për procesin e parcelës që jeni në diskutime për vendosjen e trafos te rruga "Vëllezërit Frashëri".

Nënkryetari: Ka qenë një palë, Bajram Ejupi, i cili një herë ka shprehur gatishmërinë që ta lëshojë atë vend për trafon. Ndërkohë, kur gjërat janë ofruar më shumë, ka ndërruar mendje dhe thjesht nuk është i gatshëm për këtë veprim. Jemi në hulumtim edhe me të tjerët, por sinjerisht ka hezitime edhe te pronat private, meqenëse aty nuk ka asnjë pronë publike. Kam diskutuar që kjo trafo të vendoset në rrugën tranzite të UÇK-së, por Keku i ka arsyet që është shumë larg për përçim të rrymës. Ju e dini që një procedurë është zhvilluar, ka përfunduar dhe krejt në fund Agim Kastrati (pronari) ka shprehur mosgatishmëri. Prona private është e shenjtë dhe është vullneti i qytetarëve sa i përket pronave private.

Defrim Kafexhiu: A janë mundësitë që komuna ose drejtoria ta gjejë një pronë prej 3 ose 4 ari. A ka kapacitet komuna që ta shpronësojë një parcelë të tillë, që është shumë më e lehtë për të rënë në ujdi, në krahasim me atë që ta gjejmë vetëm një hapësirë për trafo?! Të shfrytëzohet një pjesë për trafo dhe pjesa tjetër pas disa viteve mund të përdoret për ndonjë projekt tjetër të komunës.

Nënkryetari: Po, unë ju ftoj edhe juve që të jeni bashkëpunues për këtë rast. Nëse eventualisht ka vende, do ta shohim. E di që ligjërisht nuk lejohet shpronëzimi para zgjedhjeve. Momentalisht nuk mund ta bëjmë asnjë zgjidhje. Kemi shpresuar shumë që ta kryejmë këtë punë në rastin e fundit. Shpronësimit e bën komuna, vlerësimin e bën departamenti në Ministri të Financave.

Kryesuesi: Faleminderit nënkryetar! A ka dikush tjetër diçka? Nëse jo, atëherë këtu përfundon mbledhja e shtatë e KPF-së, shihemi në mbledhjen e rregullt!

Procesmbajtësi

Albion Krasniqi

KRYESUESI

Arbër Zenuni